



VENDIM RRETH ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Data e miratimit: 23 nëntor 2011

Numri i lëndës 2010-07

Z. Blerim Rudi

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT MË 8 QERSHOR 2011

1. Më 8 qershor 2011 Paneli kishte marrë vendimin e paraqitur në vijim lidhur me ankesën e paraqitur nga z. Rudi më 8 shtator 2010:

Paneli me shumicë votash,

Shpall ankesën të pranueshme sa i përket Nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe pjesën tjetër të ankesave të papranueshme;

Konstaton se ka pasur shkelje të Nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës;

Konstaton të përshtatshme, nga pikëpamja e gjetjeve të fakteve dhe ligjit, që t'i bëjë rekomandime ShM; dhe

Rekomandon që ShM t'i ndërmerr këto veprime, të paraqitura si në vijim:

- Duhet të jepet një deklaratë që pranon se rrethanat e këtij rasti përbëjnë shkelje të të drejtave të parashtruesit të ankesës që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv; dhe
- Duhet të ndërmerret një hetim rreth masave specifike të cilat ShM mund t'i ndërmerr, në mënyrë që t'i jepet fund shkeljes që është konstatuar në këtë rast.

ShM ftohet që të njoftoj Panelin rreth masave që ai ka ndërmend t'i ndërmerr në lidhje me këtë vendim deri me datën 8 gusht 2011.

Për më tepër, ShM ftohet që të njoftoj Panelin dhe parashtruesin e ankesës rreth masave që janë ndërmarrë, dhe rreth rezultateve që kanë dalë nga to, deri më datën 31 nëntor 2011.

II. INFORMATA NGA ShM I EULEX-it

2. Më 30 qershor 2011 ShM kishte njoftuar Panelin se gjetjet janë duke u studiuar dhe rekomandimet janë duke u analizuar.
3. Më 3 gusht 2011 ShM kishte njoftuar Panelin se ai kishte kërkuar më 1 korrik 2011 nga drejtori ndërkombëtar i Qendrës së Inteligjencës Financiare (më tutje si: QIF dhe Drejtori) që të ndërmerr hapa për të rikthyer z. Rudi në pozitën e tij të mëparshme dhe që të siguroj që t'i kompensohen pagat e tij të papaguara. Ai gjithashtu kishte nxitur Drejtorin për të shqyrtuar tërheqjen e lëndës në pritje kundër z. Rudi pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës (në të vërtetë, lënda në pritje kundër Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (më tutje si: KPM), shih paragrafin 9 më poshtë).
4. Më tej, ShM deklaroi se më 6 korrik 2011 Drejtori zyrtarisht kishte kërkuar që padia në pritje kundër z. Rudi të tërhiqej nga Gjykata Komunale. Përmes një vendimi me shkrim të datës 13 korrik 2011 z. Rudi ishte kthyer në pozitën e tij të mëparshme deri në përfundimin e kontratës së tij më 31 gusht 2011. Përpos kësaj, pjesa e papaguar e pagave që duhej paguhej atij, zyrtarisht i ishte kërkuar Ministrisë së Financave.

III. INFORMATA NGA Z. RUDI

5. Me kërkesë të Panelit, z. Rudi ka njoftuar Panelin më 8 shtator 2011 se ai kishte pranuar një vendim të QIF të datës 13 korrik 2011, ku thuhej se:

- Ai ishte rikthyer në pozitën e vet prej datës 25 korrik 2011, retroaktivisht nga data 28 janar 2010,
 - Gjithashtu ai duhej të merrte të gjitha pagat që i takonin atij nga data 28 janar 2010 e tutje. Kjo duhej të organizohej nga Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike,
 - Ai duhej të shfrytëzonte tërë pushimin e tij vjetor të grumbulluar deri në fund të kontratës së tij më 31 gusht 2011,
 - Kontrata e tij e punës, e vlefshme deri më 31 gusht 2011 nuk iu ishte ripërtërirë, pasi pozita e zëvendës Drejtorit të QIF nuk ishte paraparë më në strukturën e re të QIF.
6. Më 26 gusht 2011, Drejtori i QIF kishte lëshuar një vendim të ri ku thuhej se kontrata e z. Rudi nuk do të ripërtërihej pas datës 31 gusht 2011, për shkak se nuk ekzistonte pozita e zëvendës Drejtorit të QIF dhe se ai do të kompensohej për pushimin vjetor që nuk e kishte shfrytëzuar deri me atë datë.
7. Arsytimi për këtë vendim ishte se në njësi nuk kishte pozitë të ngjashme. Është përmendur Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 32 për “Lëvizshmërinë në rast të tepricës së personelit”, Neni 9 i Rregullores nr. 01/2011 për “Ndërprerjen, Pezullimin, dhe Përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil”. Si mjet ligjor kundër vendimit, vendimi mund t’i drejtohet qeverisë apo Ministrisë së Administratës Publike,.
8. Z. Rudi kishte njoftuar Panelin se më 31 tetor 2011 i ishte paguar një shumë e caktuar e të hollave prej pjesës së papaguar nga paga. Për më tej, ai nuk ishte njoftuar për asnjë ndryshim në statusin e lëndës që ishte në pritje pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës.

IV. INFORMATA SHITESË

9. Sipas informatës së pranuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, lënda në pritje kundër KPM dhe vendimit të tij për të shfuqizuar vendimin fillestar nga QIF për të ndërprerë kontratën e punës së z. Rudi (shih vendimin 2010-07, *Blerim Rudi kundër EULEX-it*, paragrafët 30-32) ishte tërhequr nga QIF më datën 6 korrik 2011. Lënda ishte mbyllur përmes një vendimi të gjykatësit të gjykatës komunale më 21 korrik 2011. Sipas njohurive të Panelit, asnjë lëndë nuk ka mbetur e pazgjidhur pranë ndonjë gjykate lidhur me z. Rudi.

V. VLERËSIM NGA PANELI

10. Paneli konstaton se ShM ka zbatuar thelbin e rekomandimeve të Panelit.

11. Në mënyrë të veçantë Paneli konstaton se ShM ka kërkuar nga Drejtori i QIF të ndërmerr hapat që do të çonin në rikthimin e parashtruesit të ankesës në pozitën e tij të mëparshme dhe pagesën e pjesës së papaguar të pagës (shih paragrafët 3 dhe 4 më lart). Në këtë mënyrë ShM në mënyrë të qartë ka pranuar shkeljen e të drejtave të parashtruesit të ankesës, siç rekomandohet nga Paneli.
12. Paneli konsideron se masat e ndërmarra në rastin e parashtruesit të ankesës duhet të shkojnë mjaft drejt rivendosjes së reputacionit profesional të parashtruesit të ankesës.
13. Pas shqyrtimit të informatave të ofruara nga palët lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

PANELI NJËZËRI

Shpall se lidhur me këtë rast, ShM i ka ushtruar funksionet siç duhet dhe,

Vendos ta mbyll hetimin e këtij rasti.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit